

E DREJTA PËR INFORMIM

Prezantohet Raporti Vjetor 2023 në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të RSh



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, prezantoi, në mbledhjen e datës 11 Qershor 2024, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2023 (Raporti Vjetor 2023).

Zyra e Komisionerit në prezantimin e Raportit “Liria e Informacionit në Ballkanin Perëndimor në 2024”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në prezantimin e Raportit “Liria e Informacionit në Ballkanin Perëndimor në 2024”. Raporti vlerëson ndryshimet dhe përmirësimet e bëra nga Shqipëria në legjislacionin mbi të drejtën e informit në funksion të adresimit të mangësive të hasura më parë.

Aktiviteti u organizua nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, të mediave dhe ekspertë të fushës së aksesit në informacion me interes publik nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Zyra e Komisionerit u përfaqësua në panelin me temë “Përmirësohemi së bashku, ankesat të (pa) suksesshme për interesin publik, këndvështrime nga institucionet publike”, ku u prezantuan risitë dhe përmirësimet e fundit të legjislacionit për të drejtën e informimit, si dhe raste konkrete me interes për të pranishmit. Diskutimi në këtë takim rajonal u përqendrua në mbikëqyrjen dhe zbatimin e kuadrit rregullator, sfidat për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, si dhe promovimin e standardeve e praktikave më të mira në këtë fushë.

Në mbështetje të iniciativave për fuqizimin e aktivizmit dhe pjesëmarrjes qytetare




Në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një vizitë studimore me aktivistë të programit “Shkëndijat”, i zbatuar nga Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Co-PLAN.

Në fokus të tij ishte njohja me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në dy fushat e përgjegjësisë, në drejtim të garantimit të ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore nga qytetarët. Nëpërmjet rasteve nga praktika nga fusha e të drejtës për informim, të pranishmit u njohën me procedurën e shqyrtimit të ankesave, transparencën proaktive të autoriteteve publike, trajtimin në balancë dhe proporcionalisht të të dy të drejtave, funksionet e koordinatorit, etj. Njëkohësisht, me interes për të pranishmit ishte edhe fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, ku u theksua zhvillimi i këtij procesi sipas standardeve më bashkëkohore dhe në funksion të një ekonomie të qëndrueshme. Ky takim i shërbeu, njëkohësisht, edhe qasjes së Zyrës së Komisionerit në mbështetje të iniciativave ndërgjegjësuëse që nxisin pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e autoriteteve publike dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile. Programi “Shkëndijat” zbatohet prej disa vitesh duke mbështetur aktivistë, profesionistë dhe organizata jofitimprurëse nga i gjithë vendi, që çojnë përpara nisma me rëndësi për komunitete të ndryshme lokale.

KONSULTONI FAQEN WWW.IDP.AL PËR TU NJOHUR ME TË REJAT
MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT



Aksesi në informacionin publik nëpërmjet instrumenteve elektronike



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave zhvilloi trajnimin online me përfaqësues të autoriteteve publike për prezantimin e funksioneve të “Regjistrimit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”. “Regjistri” është formatuar dhe funksionon në mënyrë të tillë që i gjithë procesi i trajtimit të kërkesave apo ankesave të realizohet brenda tij, ku një nga elementët kryesorë të sistemit është gjurmueshmëria. Ky instrument elektronik është i integruar në portalin “pyetshtetin.al”, një platformë komunikimi në funksion të ndërveprimit të qytetarëve me autoritetet publike për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së tyre. “Regjistri” është një bazë shtetërore të dhënash, miratuar me VKM 145/2018, i cili është i instaluar dhe funksionon në total në 240 autoritete publike të të gjitha kategorive: qendrore, të pavarura dhe në ato të vetëqeverisjes vendore; ndërsa vetëm për vitin 2024 ky numër është 19.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania